

ÇËSHTË PLANERI/PLANIFIKUESI?

Ky Planer/Planifikues përfaqëson një instrument të thjeshtë informativo – edukativ i cili ka për qëllim të mundësojë zbatimin sa më efikas të obligimit për nxitjen dhe promovimin e mundësive të barabarta të grave dhe burrave të cilat rrjedhin nga Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave (LMBGB).

Kujt i adresohet?

Ky planer/planifikues para së gjithash është përgatitur dhe adresuar për Njësitë e Vetëqeverisjes lokale (NJVL) dhe funksioni bazë i tij është ti ndihmojë për t'i intensifikuar përpjekjet lidhur me planifikimin, ndjekjen, vlerësimin dhe informimin për aktivitetet e ndërmara për arritjen e qëllimeve të LMBGB.

Duke patur parasysh që NJVL përfaqësojnë një strukturë komplekse të subjekteve të ndryshme, me ingerenca/kompetenca dhe funksione të definuara dhe të parashikuara edhe nga ligje dhe dispozita të tjera, rëndësi ka që të kihet parasysh se obligimete e LMBGB përfaqësojnë plotësim dhe zgjerim të tyre. Me fjalë të tjera, çdo njëri nga subjektet, përkatësisht kryetari i komunës, administrata, këshilli, duke i përfshirë edhe koordinatorët e komisioneve për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, në përputhje me pozicionin dhe kompetencat e tyre, duhet ta identifikojë dhe ta merr përsipër pjesën e përgjegjësisë për promovimin e barazisë ndërmjet grave dhe burrave. Kjo do të thotë se ata duhet ta inkorporojnë parimin e barazisë ndërmjet grave dhe burrave në kuadër të realizimit të kompetencave të tyre.

Kështu që, ky planer/planifikues është konceptuar si një mjet vizual i thjeshtë dhe i kapshëm, si informues, si mjet për të na kujtuar, si udhërefyes, mjet të cilin mund ta përdorin të gjitha këto struktura.

Planeri/Planifikuesi mund të shërbejë edhe si pikënisje për të shqyrtuar dhe analizuar proceset egzistuese për promovim dhe planifikim si dhe identifikimin e mundësive për transformimin e tyre, në mënyrë të tillë që do të mundësojë që NJVL t'u përgjigjen obligimeve që rrjedhin nga LMBGB, dhe kështu të kontribuojnë në realizimin e qëllimit të tij.

Planeri/Planifikuesi ka edhe vlera të tjera plotësuese. Ai mund të shërbejë edhe si instrument për ndjekjen dhe mbrojtjen/përfaqësimin e zbatimit të LMBGB nga ana e shoqatave të qytetarëve. Organizatat të cilat punojnë në sferën e promovimit të barazisë gjinore dhe atë të drejtave të grave, pa marrë parasysh fushën dhe mandatin specifik të veprimit, duhet të kenë një pasqyrë të qartë dhe ta ndjekin mënyrën me

të cilën komuna i promovon mundësitë e barabarta të grave dhe burrave, në sferat në të cilat ato veprojnë, përkatësisht çfarë aktivitetesth realizohen në bashkësinë lokale duke i patur parasysh obligimet që burrojnë nga LMBGB. Ky planer/planifikues mund të ndihmojë që ato t'i identifikojnë mangësitë, si dhe t'a nxisin pushtetin lokal për një transparencë më të madhe dhe intensifikim të përpjekjeve për realizimin në praktikë të barazisë ndërmjet grave dhe burrave.

Çfarë përmban dhe si të përdoret?

Planeri/Planifikuesi përbëhet nga tre pjesë të cilat janë të ndara vizualisht, por që janë të lidhura shumë ngushtë njëra me tjetrën.

ÇFARË THOTË LIGJI PËR MUNDËSI TË BARABARTA TË GRAVE DHE BURRAVE?

Në anën e majtë ndodhet një pasqyrë e përmbledhur për qëllimin dhe obligimet specifike që burrojnë nga LMBGB për NJVL, të cilat si një nga subjektet janë të detyruara të punojnë në realizimin e qëllimit të tij.

Ato përfaqësojnë drejtime bazë për veprimtarinë e NJVL në kontekstin e LMBGB.

Në këtë pjesë, me rëndësi është të kihet parasysh se bartës i përgjegjësisë për realizimin e qëllimit dhe zbatimin e obligimeve që burrojnë nga LMBGB është NJVL.

Roli i Komisioneve për mundësi të barabarta të grave dhe burrave dhe i koordinatorëve është ta sigurojnë mbështetjen, ekspertizën, dhe në përputhje me mundësitë dhe kompetencat specifike, të ndikojnë mbi proceset me qëllim që ato të lëvizin në drejtim të vendosjes së mundësive të barabarta të grave dhe burrave. Në këtë, duhet të meret parasysh, pozicioni dhe funksioni i tyre në kuadër të strukturës së NJVL dhe kompetencave të tyre, si dhe mundësitë dhe kufizimet për ta zbatuar këtë rol.

Kjo ndarje e obligimeve është e domosdoshme për t'u shmangur praktika e transferimit, kalimit të ngarkesës për implementimin e ligjit në punën e këtyre mekanizmave. Në fakt, sipas ligjit, pozicioni dhe ingerencat as që mundet, dhe as që duhet të jenë të vetmet përgjegjëse për promovimin e barazisë.

DREJTIME PËR PLANIFIKIM DHE VEPRIM

Në anën e djathtë ndodhet pjesa ku janë vendosur disa nga drejtimit indikative të cilat do të duhej të mundësonin operacionalizim të obligimeve specifike që burojnë nga LMBGB.

Ato përfaqësojnë ilustrim të konteksteve për veprim në të cilat do duhej (ose do të mundej) të planifikohen/realizohen/vlerësohen aktivitetet që nënkuptojnë zbatim të obligimeve ligjore. Njëkohësisht, secili nga këto kontekste specifike dhe aktivitete të mundshme janë formuluar si indikatorë të cilat mund të shfrytëzohen si bazë për përgatitjen dhe zhvillimin e planeve si dhe për përmbajtjen e raporteve vjetore të NJVL.

Për shembull:

Konteksti i **akteve dhe proçedurave** është i lidhur me obligimin e Ligjit për formimin e komisionit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave dhe caktimin e koordinatorit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave.

Këto dy obligime nënkuptojnë ndërmarjen e një sërë aktivitetsesh të lidhura me **koordinimin e akteve dhe proçedurave egzistuese dhe miratimin e akteve të reja.**

- » **Miratim i aktit të ri** - vendim i këshillit për formimin e komisionit si organ i përhershëm,
- » **Ndryshim dhe plotësim i statutit** në të cilin duhet të definohet përbërja, kompetencat, detyrat dhe obligimet ashtu siç janë definuar në LMBGB,
- » **Miratim i aktit të ri** -vendim për caktimin/nominimin e koordinatorit me të cilin caktohen detyrat dhe kompetencat e koordinatorit në përputhje me dispozitat që janë dhënë në ligj.
- » **Ndryshim dhe plotësim i aktit për sistematizim** në të cilin do të parashikohet ky pozicion dhe do të definohet fusha e veprimit dhe detyrat e koordinatorit.

Më tutje, konteksti - **Akte dhe proçedura** mund të lidhet me aktivitete të cilat nënkuptojnë zbatim të obligimeve të tjera që burojnë nga ligji, siç është për shembull obligimi për përgatitjen e raportit apo grumbullimi i treguesve statistikorë, përgatitja e planit vjetor me masa bazë dhe ato të veçanta etj.

Këto obligime të Ligjit, në planerin/planifikuesin janë konceptuar si kontekste të veçanta veprimi të emëruara si **Raporte, ose Statistika/**

analiza, Plan vjetor me masa bazë dhe të veçanta, në të cilat mundet të planifikohen/realizohen aktivitete, megjithatë, me rëndësi është të kihet parasysh se ato gjithashtu janë të lidhura ngushtë me kontekstin e akteve dhe procedurave.

Në fakt, egziston një dallim i madh kualitativ/cilësor ndërmjet një akti të miratuar në të cilin vetëm formalisht është parashikuar një procedurë, e cila do ta parashikojë, për shembull, mënyrën e përgatitjes dhe miratimit, shërbimet që duhet të involvohen në përgatitjen, formatin/përmbajtjen e raportit vjetor, dhe mungesës së një akti të tillë.

Gjithashtu, këtu bëjnë pjesë edhe aktet për rregullimin formal të procesit të përgatitjes dhe akti me të cilin miratohen planet me masat, ose akti apo procedura me të cilat krijohet obligimi për inkorporimin e parimit të mundësive të barabarta të grave dhe burrave në planet strategjike dhe buxhetet.

Këto procese mund të definojnë në mënyra joformale dhe të zhvillohen si praktika të mira dhe pa akte formale. Megjithatë, aspektet formale janë jashtëzakonisht të rëndësishme, sepse në këtë mënyrë promovohet, fuqizohet dhe qartësohet obligimi dhe rritet mundësia për të dhënë llogari/raport nga subjektet e ndryshme në NJVL të cilat duhet të jenë të përfshirë në arritjen e qëllimit të Ligjit.

Në këtë mënyrë komuna demonstroi edhe përkushtim ndaj përmbushjes së obligimeve të Ligjit në formën e një sistemi i cili është i qëndrueshëm dhe nuk varet nga interesat, përkushtimi, inisiativa dhe aftësitë individuale.

Megjithatë, vetë prania e akteve me të cilat janë definuar obligimet formale është vetëm njëra nga supozimet për vendosjen e sistemit për veprimtari të organizuar për realizimin e qëllimit të Ligjit. Në rast se ato nuk respektohen dhe nuk ndiqet zbatimi i tyre, ose nëse nuk kërkohet llogari nga ata të cilëve u është dhënë si obligim, është vështirë të pritët që të prodhohjë çfarë do lloj efekti pozitiv.

Rëndësi ka që të kihet parasysh se disa nga drtejtimit janë të lidhur ngushtë njëri me tjetrin dhe të kushtëzuara. Një shembull i tillë është lidhja e aktiviteteve për ndërtimin e **Kapaciteteve** me aftësinë e administratës për **Planifikim Strategjik/programim** gjinor të vetëdijshëm, gjë për të cilën është e domosdoshme **Statistikë/analiza** të ndara sipas përkatësisë gjinore, dhe nevoja të qytetarëve të shqyrtuara të cilat mund të identifikohen me **Konsultime**. Planet nuk janë me shumë rëndësi, nëse për to nuk ka shpërndrje/alokim mjetesh, me fjalë të tjera **Buxhet për realizimin e tyre**. Prandaj, procesi i përgatitjes së planeve duhet t'i mer parasysh çdo njërin nga këto kontekste.

FLETË/FAQE PËR SHËNIME

Pjesa e mesme është paraparë për regjistrimin e aktiviteteve në një kornizë kohore

Duke patur parasysh hapësirën e kufizuar në fushat e përcaktuara për muajt e vitit, do të jetë mirë të regjistrohen aktivitete mujore më të rëndësishme të planifikuara (si detyra që duhet në mënyrë operative të planifikohen dhe të realizohen në një afat të caktuar) dhe rregullisht, pas mbarimit të muajit të shënohet nëse janë realizuar.

E pëlqyeshme është që planeri/planifikuesi të vendoset në vend të dukshëm për të punësuarit në shërbimet dhe/ose këshilltarët/et, dhe të caktohen persona që do t'i shënojnë aktivitetet. Gjithashtu, duhet të përcaktohet mënyra e shënimit/regjistrimit të aktivitetit në kalendar. Si do që të jetë, shënimet duhet të bëhen në mënyrë të tillë që do të mundësojnë të theksohet shkurtimisht dhe qartë kur do të ndodhë aktiviteti, kush e realizon dhe cila është përmbytja e tij.

Më poshtë është prezantuar shembull për atë se si duhet të bëhet shënimi. Ai përfaqëson një propozim për ta ilustruar dinamikën e mundshme dhe mënyrën në të cilën do të rrjedhin proceset, kush duhet të përfshihet në realizimin e tyre, njëkohësisht ofron edhe ide për aktivitete specifike të cilat komuna mund t'i ndërmarë në kuadër të LMBGB, dhe që nuk përbahen në drejtimet për veprim të përmbytura në pllanerin/planifikuesin.

Janar

Shkurt

15

Prezantim publik i planit vjetor të komunës me masa dhe mjete buxhetore për MBGB për OJQ - të, institucionet, bashkësitë vendore)

(Kordinator, Departamenti për Planifikimin Strategjik dhe Buxhet, shërbimi për marrëdhënie me publikun, KMBGB)

25

Seancë e KMBGB/Shqyrtim dhe miratim i draftit të raportit vjetor për masat e zbatuara për MBGB gjatë vitit të kaluar

Mars

6-8

Festimi i ditës ndërkombëtare për të drejtat e gruas:

- Debat për statusin dhe pozicionin e grave në komunë
- Seancë tematike publike e Këshillit - Qytetarët pyesin???

15

Seancë e këshillit - Miratim i raportit vjetor për MBGB (kordinator, departamenti për mbështetje të këshillit)

31

Dorëzim i raportit vjetor pranë MPPS

Shpallje në veb - faqen

(kordinator, veb - administrator)

Prill

10

Seancë e KMBGB - Informim për pjesëmarrjen e grave në vetëqeverisjen vendore me propozim - masash

(kordinator, person i angazhuar për vetëqeverisjen vendore, departamenti për mbështetje të këshillit)

15

Seancë e këshillit - vendim për miratim të propozim - masave për promovimin e pjesëmarrjes së grave në vetëqeverisjen vendore.

(kordinator, departamenti për mbështetje të këshillit)

Maj

14 - 16

Trajnim "Planifikim gjinor i vetëdijshëm" - administrata
(koordinator, sekretar i komunës, sektori për resurse njerëzore)

Qershor

1 - 30

Azhurim i statistikës së ndarë në aspektin gjinor (sipas gjinisë, përkatësisë etnike, paaftësisë)

Arësim parashkollor/punësim, obligues të tatimit/shfrytëzues të ndihmës sociale sipas llojeve, viktima të dhunës..../

(koordinator, sektorët, departamentet)

Korrik

2

Mbledhje koordinator dhe KMBGB - shqyrtim i një përmbledhjeje informacioni

5

Dorëzim i propozim - inisjativash pranë kryetarit të Komunës
(koordinator)

Gusht

Shtator

Distribuem i formularit për propozim - masash për KMBGB nga institucionet, OJQ dhe BV (planifikim i programeve)

Tetor

1 - 10

Konsultime për MBGB (përgatitja e propozim programeve)

12

Debat publik për MBGB

15

Mbledhje për shqyrtim të propozimeve

(koordinator, sektorë dhe departamente)

Nëntor

1 - 10

Përgatitja e propozim programit dhe buxhetit për MBGB

13

Mbledhje konsultative e kryetarit të komunës/kordinatorit/
KMBGB

20 - Seancë e KMBGB (Shqyrtimi dhe miratimi i draftit të programit vjetor me masa dhe buxhet për MBGB; miratim propozimesh për programin vjetor për punë të Këshillit)

Dhjetor

Seancë e KMBGB - Shqyrtimi i propozim buxhetit
(amandamente)

Propozim programi për punë të këshillit për vitin e ardhshëm

Seancë e Këshillit - miratim i buxhetit dhe propozimeve të
KMBGB për programin vjetor për punë të Këshillit

Përpunimi i detajuar dhe regjistrimi i mënyrës së zbatimit të çdo njëjës prej këtyre detyrave duhet të jetë obligim i personave të caktuar si përgjegjës/të kyçur në realizimin e tyre. Prej tyre, më tutje, në formën e raporteve të shkurtra nga aktiviteti do të nxiren dhe/ose ndahen ose inkorporohen informacionet në raporte në sferat e ndryshme që janë kompetencë e NJVL për atë se çështë bërë dhe arritur në planin e promovimit të MBGB.

Edhe pse struktura dhe vëllimi i administratës, kapacitetet dhe dinamika me të cilën zhvillohen proceset e planifikimit, miratimit dhe realizimit të aktiviteteve ndryshon nga komuna në komunë, egzistojnë disa procese të cilat zhvillohen sipas afateve ligjore të përcaktuara qartë dhe sipas një mënyre të planifikimit dhe realizimit, siç është për shembull procesi i buxhetit. Prandaj, plani i aktiviteteve të ndërmara në kontekstin e LMBGB, patjetër duhet të përshtatet me dinamikën e përcaktuar të këtyre proceseve.